RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

KOMUNIKATË

Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës, Zgjodhi Kryesinë e re dhe Ushtruesen e Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

Sot, me datë 05 maj 2026, në mbledhjen e mbajtur, Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës, në përputhje me dispozitat e Ligjit për RTK-në, Statutit të RTK-së, si dhe Rregullores së punës së Bordit të RTK-së, zgjodhi kryesinë e re.

Pas emërimit të anëtarëve të rinj të Bordit dhe funksionalizimit të tij, z. Dardan Beqiri u zgjodh Kryetar i Bordit të RTK-së, ndërsa znj. Xheraldina Cërnobregu u zgjodh Nënkryetare.
Gjithashtu, në këtë mbledhje, Bordi i RTK-së, me shumicë votash, caktoi znj. Zana Spahiu si Ushtruese e Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

Kryesia e re falënderoi anëtarët e Bordit për besimin e dhënë dhe shprehu përkushtimin për avancimin e mëtejmë të zhvillimit të RTK-së, duke u angazhuar për respektimin e standardeve më të larta profesionale dhe forcimin e rolit të transmetuesit publik.